



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300732/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Lezhë.

Drejtuar: Drejtues i Parë Z. Alfred ELEZI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë

LEZHË

Kryekomisar Z. Behar CAKA
Shef i Komisarimit të Policisë Lezhë

LEZHË

Për dijëni: Drejtues Madhor Z. Mehmet RRUMBULLAKU
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Lezhë nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Lezhë.

Inspektimi u krye në datën 01.09.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej z. Hazbi Selita dhe znj. Lindita Dedgjoni, me detyrë Nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

MKPT, bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të emigrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria, azilkërkuesit, institucionet psikiatrike dhe shtëpitë e të moshuarve.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde të punës “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e e Komisarariatit z. Behar Caka dhe shefin e Rendit z. Bardhyl Saliu, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i Rendit informoi grupin e inspektimit për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisarariat, trajtimi i personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi takimin me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit dhe të shërbimit në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, inspektoi ambientet ku privohet liria e personit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të Komisarariatit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që zhvilloi grupi i punës në ambientet e këtij Komisarirati.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit të kaluar¹, si dhe nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të shoqëruarit dhe të ndaluarit/arrestuarit, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për reduktimin e mbipopullimit të personave në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, deri në shtimin e dhomave të sigurisë.

¹ Rekomandim për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Lezhë.

2. Ishte zbatuar rekomandimi nga ana e stafit të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave të të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve, në lidhje me vizitat mjekësore, si dhe konsultat e specializuara në Spitalin Rajonal Lezhë.
3. Ishte zbatuar rekomandimi, për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, për plotësimin në kohë e me përgjegjësi të regjistrit të kërkesë/ankesave të shtetasve, për të bërë sa më efektiv sistemin e kërkesë/ankesave.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për respektimin e të drejtës ligjore për t'u takuar e mbrojtur me avokat për shtetasit e arrestuar/ndaluar në organet e Policisë së Shtetit që në momentet e para të shoqërimit të tyre.
5. Ishte zbatuar rekomandimi, për dhënien e kartës së të drejtave që në momentin në të cilin palët hyjnë në komisariat.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Lezhë.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kritereve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.
3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e dhomave/ambienteve të intervistimit në këtë Komisarariat, për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për mirëmbajtjen dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare, pastërtisë së tualetit dhe të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Lezhë, si dhe lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.
7. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e tualeteve të dhomave të shoqërimit me bolierë për ngrohjen e ujit për të qenë sa më funksionale për personat e

shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë.

8. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë².

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të dhomave të shoqërimit, ndalimit/arrestimit dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në konflikt me ligjin, rekomandimet e Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato iu drejtohen. Këto rekomandime nuk iu drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është aspak serioze që me ndryshimin e titullarëve të institucioneve (Komisariateve të Policisë) të mos mbahen në vëmendje apo më keq të ndryshojë edhe qëndrimi ndaj rekomandimeve të bëra më parë nga Avokati i Popullit, sikurse ka ndodhur dhe në këtë rast për mos zbatimin e rekomandimeve në Komisariatin e Policisë Lezhë.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësi vendore, por çdo Komisariat duhet të demonstrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve.

Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se, në Komisariatin e Policisë Lezhë ishin marrë masa për përmirësimin e standardeve lidhur me garantimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, por vazhdonin të ishin të pranishme edhe disa problematika, të cilat po i parashtrijmë më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Lezhë, mjedisi i shoqërimit në tërësi ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, duke krijuar dhoma shoqërimi të ndara më vete për femra, personat e rritur dhe të miturit³.

Në këtë Komisariat, ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës kryesore. Ai përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi, të ndara më vete për gra, personat e rritur dhe të miturit. Dhomat e shoqërimit kishin hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme dhe ishin të pajisura me tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 5x3m² dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë. Sipas informacionit të dhënë, kapaciteti në këto ambiente ishte deri në 12 shtetas të shoqëruar për konflikt me ligjin.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Në dhoma kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

² Kreu VII, pika 4/d e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

³ Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Mjediset e dhomës së shoqërimit nuk ishin të mirëmbajtura, si dhe kishin nevojë për lysterje dhe për t'u mbajtur pastër nga ana higjieno-sanitare. Brenda në dhomat e shoqërimit ndodheshin tualete për meshkuj, ashtu dhe për femra. Këto ambiente ishin të pajisura me materialet e duhura hidrosanitare dhe kishin ujë të rrjedhshëm në 24 orë, por mungonin bolierët për ngrohjen e ujit, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës personale të personave të shoqëruar në këtë institucion.

Ne vlerësojmë se kushtet higjieno-sanitare janë shumë të rëndësishme në ambientet e privimit të lirisë dhe gjendja e tyre varet nga organizimi i punës dhe për këtë shkak Avokati i Popullit kërkon vëmendje maksimale nga drejtuesit e Komisarariatit dhe stafi përgjegjës. Pastërtia e ambienteve është thelbësore pasi tregon qartë kujdesin ndaj të shoqëruareve dhe është e përballueshme nga pikëpamja e kostove.

Në mjedisin e shoqërimit ndodhej një ambient me dhomë dhe paradhomë për kryerjen e “përgjimit ambiental dhe njohjes me persona nën hetime penale për veprime procedurale” të bëra nga punonjësi i policisë, sikurse parashikohet në ligj, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga organi i prokurorisë⁴.

Nga inspektimi i ambienteve të dhomave të shoqërimit, u konstatua se gjendja teknike e godinës ishte e mirë, por kishte prezencë të lagështirës. Ky shqetësim, u evidentua edhe nga stafi i Komisarariatit, të cilët na informuan se lagështira ishte e evidente në gjithë katin e parë të godinës së Komisarariatit, por më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve dhe në dhomat e shoqërimit, në të cilat kishte rënë suvaja për shkak të saj. Niveli i lagështirës ishte tej normave të pranueshme, dhe si pasojë ka ndikim negativ në jetën dhe shëndetin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe për vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Gjatë inspektimit, u evidentua se ishte krijuar një mjedis i ri i quajtur “Hapësirë miqësore për fëmijët”, që shërbente për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të mitur në konflikt me ligjin. Ky ambient, përbëhej nga 3 dhoma të kompletuara me pajisje dhe orenditë e nevojshme për mbrojtjen dhe trajtimin dinjitoz të të miturit, viktimë e një veprë penale, gjatë procesit të hetimit.

Korridori i dhomave të shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Lezhë, ishte i survejuar nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve.

Në Komisarariatin e Policisë Lezhë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 01.09.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **385** persona, nga të cilët saktësisht **366** shtetas madhorë, **17** shtetas të mitur dhe **2** shtetase gra të shoqëruara në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe nenin 112/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e Komisarariatit dhe për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

⁴ Neni 131, pika1/a e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Gjatë inspektimit, u evidentua gjithashtu se në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, me qëllim që këto të drejta të njihen dhe të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar.

Nga inspektimi u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Lezhë, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar në tërësi sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Ambientet e sigurisë përbëheshin nga 4 dhoma sigurie me kapacitet zyrtar për 6 persona. Konkretisht 2 dhoma me nga 1 (një) person secila, ndërsa 2 (dy) dhoma të tjera me 2 persona, të ndara në dhoma për të rritur, në dhoma për femra dhe në dhoma për të mitur, sipas kërkesës së ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 (dy) persona, në cilësinë e të arrestuarit dhe të ndaluarit.

Ambientet e dhomave të sigurisë ndahen në dy pjesë, në ambientin për jetesë, si dhe në paradhomën që shërbente për qëndrimin e personave në orare të caktuara dhe për pastrim vetjak, pasi ndodhej çezma me lavaman. Dy prej dhomave ishin të pajisura me nga dy shtretër me krevatë dhe dy të tjera me nga një shtrat me krevat.

Dhomat e sigurisë për femra dhe të mitur i plotësonin normat dhe parametrat teknik jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².

Ndërsa dy dhomat për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë, ndonëse ishin të ndara në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m², **nuk** plotësonin kriteret për sipërfaqen e nevojshme për jetesë për dy persona⁵.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla, që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Çdo dhomë ishte e pajisur me tualete brenda dhe me orenditë e nevojshme për jetesë si krevat, dyshekë, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (1 dush me ujë të ngrohtë), i cili

⁵ Kreu V, pika 3.3 e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

ndodhej në korridor. Dushet ishin funksionale dhe punonin me sistem qendror, po ashtu në paradhomën e dusheve kishte dhe tualet të përbashkët, i cili ishte i pajisur me të gjitha pajisjet që shërbejnë për këtë qëllim.

Larja e batanijeve dhe ndërimi i materialeve të vjetëruara apo dëmtuara që shërbenin për fjetje në dhomat e sigurisë, kryhej periodikisht sipas një grafiku të miratuar nga struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Policisë Lezhë.

Në ambientet e sigurisë **nuk** kishte sistem ngrohjeje/ftohjeje me sistem qendror sipas kushteve klimaterike, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, por për periudhën e dimrit institucioni kishte siguruar pajisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në moment nevojë. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Ambienti i sigurisë kishte një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku/ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, por në këtë Komisarariat, vazhdonte të ekzistonte mungesa e mjekut të punësuar me kohë të plotë. Sipas informacionit të drejtuesve të Komisarariatit, mjeku është me kohë të pjesshme në institucion.

Mungesa e mjekut/ndihmësmjekut me kohë të plotë është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në ligj dhe në procedurën standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, si dhe aktet ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë qartë kryerjen e detyrueshme të vizitës mjekësore brenda afatit 12 orë, nga koha e hyrjes të personave të ndaluar/arrestuar në ambientin e sigurisë pavarësisht se nuk kishin ankesa në drejtim të mjekut dhe mjeku duhet të ishte i pranishëm sa herë që ishte e nevojshme nga të të ndaluarit/arrestuarit. Kryerja e vizitave mjekësore dhe evidentimi i tyre në kartelë dhe regjistrin përkatës të Komisarariatit të Policisë⁶, janë detyrim ligjor për mjekun/ndihmësmjekun, por dhe për drejtuesit dhe punonjësit e policisë, pasi duhet të garantojnë shërbimin shëndetësor të nevojshëm ndaj këtyre personave, gjatë gjithë periudhës që ata ndodhen në mjediset e policisë.

Mekanizmi Kombëtar konstaton në mënyrë përsëritur se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente dhe si rrjedhojë pasojat mund të jenë të rënda.

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët privatë, e cila shërbente njëkohësisht edhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave, por brenda saj **nuk** ishte instaluar sistemi

⁶ Kreu II, pika 7, e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në Policinë e Shtetit”.

audio-viziv për vëzhguar veprimet e policisë me personat e ndaluar/arrestuar, si dhe për të parandaluar çdo kundërveprim të tyre ndaj punonjësve të policisë.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave përgjatë 24 orëve.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatin e Policisë Lezhë, u evidentua se zbatoheshin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019, ku çdo njësi policie që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të pajiset me regjistrat për evidentimin e të dhënave të personave në cilësinë e të shoqëruarve apo të ndaluarve/arrestuarve në mjediset e policisë. Regjistrat ishin të mbajtur në rregull dhe të plotësuar sipas rubrikave.

“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1”, konform me procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në Policinë e Shtetit” dhe ishte i sekretuar. Personat e shoqëruar për në mjedisin e policisë të Komisarariatit, sipas dispozitave ligjore, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësi i policisë së zyrës së informacionit⁷.

Në këtë Komisariat ndodhej edhe “Regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar”, ku regjistroheshin të dhënat e këtyre personave, sipas procedurave të kryera nga punonjësit e Komisariateve të Policisë Lezhë, Laç dhe Mirditë. Ky regjistër gjithashtu ishte i sekretuar dhe i plotësuar sipas rubrikave.

Nga këqyrja e këtij regjistri, por dhe nga procesverbalet e personave të ndaluar/arrestuar që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në mjedisin e policisë. Kjo praktikë ndiqej nga punonjësit e Komisariateve të Policisë në Lezhë, Laç dhe Mirditë, të cilët në procesverbalin e personave të ndaluar/arrestuar që shoqëroheshin për në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, shënonin orën kur atyre iu privohej liria në momentin e shoqërimit në mjediset e komisariateve respektive. Dokumentimi i saktë i kohës në procesverbalin e personave të ndaluar/arrestuar, që në momentin e privimit të lirisë në mjediset e policisë, përbën garanci për këta persona në llogaritjen e kohës gjatë qëndrimit në këto mjedise, pavarësisht lëvizjeve nga Komisariati i Policisë Laç dhe Mirditë, për në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat nuk administrohej regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Sa më sipër përbën cënim të standardit

⁷ Kreu VIII, i procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

të parashikuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, përkatësisht në Kreun XV *“Procedurat për evidentimin dhe trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar”*, pika 5.1, gërma “c”⁸.

Nga inspektimi u konstatua se Komisariati i Policisë Lezhë, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 ishin 17 të mitur në konflikt me ligjin⁹.

Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Lezhë nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 (dy) persona të arrestuar/ndaluar.

Nga intervistat që zhvilloi grupi i inspektimit me personat e ndaluar/arrestuar, u konstatua se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte nga punonjësit e shërbimit të dhomave të sigurisë, si dhe gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Personat e arrestuar nuk paraqitën asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë procesit të marrjes në pyetje, si dhe nga punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë.

Nga verifikimi i librit të ankesave dhe kërkesave, u evidentua se nuk kishte asnjë ankesë apo pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë.

Nga intervistat me personat e ndaluar/arrestuar dhe informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej dhe shërbehej nga një subjekt privat që ushtronte aktivitetin brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve, u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë nuk ka ambiente ajrimi për persona ndaluar/ arrestuar siç parashikohet në Kreun VI, pika 1.14 të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe*

⁸ Punonjësi i policisë që merr ankesë/kërkesën e pasqyron atë në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan për këtë gjë në rubrikën përkatëse të regjistrin.

⁹ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

zgjdhja e kërkesë/ankesave të tyre”, ku thuhet se personi i ndaluar/arrestuar mund të dalë në ajrim sipas mundësive dhe kushteve që kanë ambientet e dhomave të sigurisë, por jo më pak se dy orë në ditë (për ato ambiente sigurie që nuk plotësojnë kushtet për ajrim e ndriçim të plotë natyral).

Në vijim, nga intervistat me personat e arrestuar që ndodheshin në momentin e inspektimit, u evidentua se ishin furnizuar me detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen pastër të higjienës personale, ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takim me avokatët. Kjo dhomë **nuk** ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave.

Shtetasit e shoqëruar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Sa më sipër, kjo situatë e pazgjdhur vjen në kundërshtim me pikën 6, kreu XIV të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, ku përcaktohet se: *“Dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të të arrestuarve/ndaluarve duhet të monitorohen nga sistemi i kamerave për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit”*.

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe të rekomandimeve të CPT-së, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon MKPT-ja në Drejtoritë dhe Komisarariatet e Policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar¹⁰.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

¹⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore në kohën e inspektimit, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe nenin 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit të personave të ndaluar/arrestuar nga grupi i inspektimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Gjithashtu nga mbikëqyrja e fashikullit të dosjes për persona të shoqëruar ndaluar/arrestuar, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhorë, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Koha më e zgjatur në marrjen kontakt të personit të privimit lirisë me avokatin ishte afërsisht 2 orë.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu sigurohet nga Bashkia Lezhë si dhe nga Shkollat e Mesme të qytetit, dhe kishte detyrimin të asistonte të miturin deri në përfundim të procedurave përkatëse.

Ndërkohë në organikën e Drejtorisë Vendore Lezhë ishte vakant pozicioni i psikologut, pasi psikologu i kësaj drejtorie kishte dhënë dorëheqjen nga ky pozicion. Institucioni kishte hapur procedurat e rekrutimit për emërimin e psikologut në këtë institucion. Sipas informacionit të drejtuesve të Komisarariatit janë bërë të gjitha procedurat për emërimin e psikologut në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, por interesi për këtë pozicion punë është i ulët.

Mungesa e psikologut në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, që në momentin e hyrjes në ambientet e Komisariateve, përbën çenim të të drejtave të të miturit në konflikt me ligjin. Avokati i Popullit kërkon marrjen e masave të menjëhershme për emërimin e psikologut siç parashikon organika e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë për të ofruar dhe për të siguruar ndaj të miturve në konflikt me ligjin, që në orët e para të shoqërimit në ambientet e Komisarariatit, asistencën e psikologut, duke siguruar pyetjet në mënyrë të duhur. Në këtë mënyrë lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tyre, duke bërë kujdes për eliminuarin frikësimit ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.

Nga informacioni i marrë nga shefi i Rendit, u informuam se shërbimet shëndetësore për personat e ndaluar/arrestuar kryhen nga mjeku i emëruar me kohë të pjesshme në këtë institucion, i cili vinte çdo ditë, ndërsa për raste urgjente të ndaluarit/arrestuarit dërgohen në Spitalin Rajonal Lezhë.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e mjekut në këtë institucion ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, me një mjek me kohë të plotë, pasi mund të ketë raste urgjente dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”¹¹.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Lezhë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ato ishin të vendosur në korridoret e këtyre ambienteve, dhe ishin të afishuara dhe në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga këta persona.

Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Nga rradhët e punonjësve të policisë të këtij komisarati, ishin trajnuar dhe specializuar 2 punonjës policie që administronin dhe asistonin procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”

REKOMANDOJMË:

¹¹ Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të shoqërimit dhe ato të sigurisë në Komisariatin e Policisë Lezhë.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e pozicionit të psikologut dhe mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për të ofruar mbështetje për trajtimin e problematikave të rasteve të personave të mitur në konflikt me ligjin që në orën e parë të shoqërimit në ambientet e privimit të lirisë.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për mirëmbajtjen dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë së tualetit dhe të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Lezhë, si dhe lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e tualeteve të dhomave të shoqërimit me bolierë për ngrohjen e ujit për të qenë sa më funksionale për personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente¹².
8. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e ambienteve të ajrimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, për persona të ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI

¹² Kreu VII, pika 4/d e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.